

DEKRET
Nr. 8566, datë 16.5.2014

PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 45/2014 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9049, DATË 10.4.2003, “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR””

Në mbështetje të neneve 93 dhe 85, pika 1, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar””.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 29/2014

PËR PUBLIKIMIN E SHPALLJES SË VENDIT VAKANT TË KRYETARIT TË AUTORITETIT TË
MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Publikimin e shpalljes së vendit vakant të Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2014